



**Instituti për Bashkitë Shqiptare**  
*'për qytete të qëndrueshme'*

---

**Njoftim për shtyrjen e thirrjes**

Afati për aplikimin në thirrjen për Shërbime logjistike për organizimin e takimeve dhe trajnimeve, Projekti “E ardhmja e Bashkisë - ndërtuar mbi rini të fortë” shtyhet me 7 ditë kalendarike.

**Afati i ri i aplikimeve është data 7 shkurt 2025.**

**Ftesë për ofertë**

**Shërbime logjistike për organizimin e takimeve dhe trajnimeve**  
**Projekti “E ardhmja e Bashkisë - ndërtuar mbi rini të fortë”**

**Autoritet kontraktues:** Instituti për Bashkitë e Shqipërisë  
Rr. “Skerdilajd Llagami”, Ndr. 3/9, Tiranë  
M31318452D

**Data e publikimit:** 20 janar 2025

Instituti për Bashkitë e Shqipërisë është një organizatë e shoqërisë civile, me interes të kontribuojë për progresin dhe zhvillimet lokale, rajonale dhe kombëtare, për një qeverisje të mirë dhe decentralizim përmes asistencës, kërkimeve, studimeve dhe trajnimeve profesionale, duke përdorur vetëm mjete dhe rrugë ligjore dhe demokratike.

IBSh ka nisur zbatimin e Projektit “E ardhmja e Bashkisë - ndërtuar mbi rini të fortë”, mbështetur nga bashkia Kavajë si pjesë e Programit ReLOaD2. Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 (ReLOaD2) është një iniciativë e financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga PNUD në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë.

Në zbatim të këtij projekti, Instituti për Bashkitë publikon këtë Ftesë për ofertë për subjektet e interesuara për shërbimet logjistike të detajuara më poshtë.



**Instituti për Bashkitë Shqiptare**  
*'për qytete të qëndrueshme'*

**1. Shërbimet e kërkuara**

Subjektet e interesuara kërkohen të ofrojnë shërbime logjistike në mbështetje të aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve që do të zhvillohen sipas specifikave dhe kalendarit të mëposhtëm.

<b>Aktiviteti</b>	<b>4.1.1 Trajnim mbi organizimin dhe funksionimin e këshillit</b>
Muaji	Shkurt 2025
Nr. i pjesëmarrësve	25
Shërbimet:	Sallë trajnimi për 25 persona Projektor Materiale trajnimi (blloqe, stilolapsa, markera) Pushim kafe (kafe, ujë, çaj, freskuese, biskota) për 25 persona Drekë pune për 25 persona (pa pije alkolike)
Buxheti maksimal	75,000 lek (me TVSH)

<b>Aktiviteti</b>	<b>4.2.1 Trajnim për qeverisjen vendore</b>
Muaji	Mars 2025
Nr. i pjesëmarrësve	30
Shërbimet:	Sallë trajnimi për 30 persona Projektor Materiale trajnimi (blloqe, stilolapsa, markera) Pushim kafe (kafe, ujë, çaj, freskuese, biskota) për 30 persona Drekë pune për 30 persona (pa pije alkolike)
Buxheti maksimal	87,500 lek (me TVSH)

<b>Aktiviteti</b>	<b>4.2.3 Trajnim mbi administrimin publik dhe menaxhim</b>
Muaji	Mars 2025
Nr. i pjesëmarrësve	30
Shërbimet:	Sallë trajnimi për 30 persona Projektor Materiale trajnimi (blloqe, stilolapsa, markera) Pushim kafe (kafe, ujë, çaj, freskuese, biskota) për 30 persona Drekë pune për 30 persona (pa pije alkolike)
Buxheti maksimal	87,500 lek (me TVSH)

<b>Aktiviteti</b>	<b>4.2.4 Trajnim për advokim dhe lobim</b>
Muaji	Prill 2025
Nr. i pjesëmarrësve	30
Shërbimet:	Sallë trajnimi për 30 persona Projektor Materiale trajnimi (blloqe, stilolapsa, markera) Pushim kafe (kafe, ujë, çaj, freskuese, biskota) për 30 persona Drekë pune për 30 persona (pa pije alkolike)



**Instituti për Bashkitë Shqiptare**  
'për qytete të qëndrueshme'

Buxheti maksimal	87,500 lek (me TVSH)
------------------	----------------------

<b>Aktiviteti</b>	<b>4.2.5 Trajnim për ESG</b>
Muaji	Prill 2025
Nr. i pjesëmarrësve	30
Shërbimet:	Sallë trajnimi për 30 persona Projektor Materiale trajnimi (blloqe, stilolapsa, markera) Pushim kafe (kafe, ujë, çaj, freskuese, biskota) për 30 persona Drekë pune për 30 persona (pa pije alkolike)
Buxheti maksimal	87,500 lek (me TVSH)

<b>Aktiviteti</b>	<b>4.4.1 Trajnim në komunikim dhe media</b>
Muaji	Korrik 2025
Nr. i pjesëmarrësve	25
Shërbimet:	Sallë trajnimi për 25 persona Projektor Materiale trajnimi (blloqe, stilolapsa, markera) Pushim kafe (kafe, ujë, çaj, freskuese, biskota) për 25 persona Drekë pune për 25 persona (pa pije alkolike)
Buxheti maksimal	75,000 lek (me TVSH)

## 2. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë teknike dhe ekonomike. Kriteret teknike kanë 70% të pikëve të vlerësimit dhe kriteri ekonomik ka 30% të pikëve.

Kriteret teknike : Subjektet e interesuara duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme teknike:

- 2.1 Të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Bashkisë e Kavajë
- 2.2 Të ofrojnë shërbime bar -restorant-konferenca me logjistiken perkatëse.
- 2.3 Të kenë ambiente të përshtatshme dhe të qeta për zhvillimin e trajnimit
- 2.4 Të ofrojnë parking për pjesëmarrësit.

Kriteri ekonomik është respektimi i buxhetit të aktiviteteve sipas këtij njoftimi, cilësia e afuar, afatet, inovacioni dhe ndikimi në mjedis.

## 3. Afati

Aktivitetet do të zhvillohen gjatë periudhës shkurt – korrik 2025. Datat specifike të organizimit të aktiviteteve do të njoftohen 5 ditë kalendarike paraprakisht.



**Instituti për Bashkitë Shqiptare**  
*'për qytete të qëndrueshme'*

---

**4. Buxheti**

Buxheti maksimal për këtë ofertë është 500,000 lekë me TVSH. Pagesat do të kryhen të ndara sipas aktiviteteve përmes transfertave bankare deri në 5 ditë kalendarike pas aktivitetit. Pagesat me lekë në dorë nuk janë të lejuara.

**5. Aplikimi**

Subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- 5.1 Ekstrakt të nxjerrë nga Qendra Kombëtare e Biznesit
- 5.2 Kopje të NIPT-it
- 5.3 Foto të ambienteve të brendshme dhe të jashtme
- 5.4 Menunë për pushimin e kafes dhe drekës
- 5.5 Ofertën ekonomike përfshirë TVSH.

Aplikimet duhet të dërgohen online në adresën e emailit [info@iam.org.al](mailto:info@iam.org.al) dhe titulli i emailit duhet të jetë **Shërbime logjistike për organizimin e trajnimeve**. Afati për dorëzimin e aplikimeve është data 7 shkurt 2025, ora 16:00.